



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0726

OSHP: 2024/0734

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operoret Ekonomik OE “Arhiko.ing” SH.P.K. dhe ankesës nga OE “Studio Hapsira” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi I Projekteve zbatuese”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Kuvendi Komunal I Klina, me datën 16.10.2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa Operoreve Ekonomik “Arhiko.ing” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 09.08.2024 me numër protokoll (2024/0726) dhe ankesa e OE “Studio Hapsira” SH.P.K.” e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.08.2024 (me numër protokoll (2024/0734) lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi I Projekteve zbatuese” me nr. të prokurimit:”634-24-4723-2-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Kuvendi Komunal I Klina.
2. Mbetet në fuqi, vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi I Projekteve zbatuese” me nr. të prokurimit:” 634-24-4723-2-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal I Klina.
3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohen operoret ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.05.2024, Komuna e Klines në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi I Projekteve zbatuese” me numër të prokurimit:634-24-4723-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 300,000.00 €.

Me 15.03.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontrate: GOE “Nil Engineering”&”GeoMap” SH.P.K. per vlerën e poentuar 10.47 Euro, ndërsa vlera e përgjithshme e planifikuar është 300,000.00 Euro.

Me 30.07.2024, OE “Arhiko.ing” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 31.07.2024 po ashtu edhe OE “Studio Hapsira”SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 02.08.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe te vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 09/08/2024, OEA “Arhiko.ing” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 726/24.

Ndërsa me datë 12/08/2024 OE “Studio Hapsira ” ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 734/24.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0726/2024 dhe ankesa nr. 0734/2024 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arhiko.ing” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Me datën 15.05.2024 AK – Kuvendi Komunal i Klinës përmes platformës publike e-prokurimi ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve zbatuese” me numër prokurimi: 634-24-4723-2-1-1. Kompania jonë, pra Operatori

Ekonomik ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit Autoritetit Kontraktues. Me datën 12.07.2024 është publikuar Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku në këtë vendim ju si AK keni shpallur fitues “GOE Nil Engineering SHPK & N.SH. Geo-Map” ku dhe me datën 12.07.2024 kemi kërkuar qasje, ku pas qasjes me 15.07.2024 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim nr.1 ku kjo kërkesë na është aprovuar me datën 16.07.2024 ndërsa lënda është kthyer në rivlerësim, pas rivlerësimit është marrë po i njëjti vendim me datën 26.07.2024, ndërsa kompania jonë përsëri pas rivlerësimit me datën 30.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ku kjo kërkesë na është refuzuar me datën 02.08.2024. 1.Në mënyrë të kundërligjshme na ka shpallur të pa Suksesshëm në këtë aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.) 2.Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT). Pas qasjes që kishim ne e kemi të paqartë se si AK ka shpallur fitues një OE i cili është dashur të eliminohet nga procedura e prokurimit pasi që çmimet e ofruara janë çmime jonormalisht të ulëta. Pasi që në pozicionin Punimi i elaboratit gjeomekanik për ura, rrugë, mure mbrojtëse - llog.per 1m- është ofruar çmimi 0.35CentDuke e analizuar bashkëpunimin tonë me shumë kompani të cilat kryejnë këtë shërbim është e pamundur që një metër gjatësi të kushtoj 0.35cent/m’. Ndërsa çmimet në vendin tonë për këtë shërbim çmimi minimal është 50Euro. Ku të bashkangjitur do e gjeni edhe një faturë tatimore të shërbimit të tillë të ofruar nga një kompani e cila kryen këto punë. Ku çmimi i tillë është 50Euro për 1m’, ndërsa OE i shpallur i përgjegjshëm ka ofruar çmimin 0.35cent që i bie 1,428.57% me lirë sesa çmimi real që ofrohet në vendin tonë dhe me këtë AK, nuk ka bërë kërkesë për sqarim të dosjes së tenderit, për arsye se është ditur që automatikisht do të eliminohet nga procedura e vlerësimit. Për këto çmime kompania jonë është ankuar edhe për procedurë të tenderimit, të ngjashme ku edhe në vendimin e Panelisht Shqyrtues 1034/23-të datës 07.02.2024, mund të shihni edhe vendimin në lidhje me çmimin e Hartimit të elaboratit. Gjithashtu edhe në vendimin e Panelit Shqyrtues 431/24- të datës 03.07.2024-mund të shihni edhe vendimin në lidhje me çmimin e Hartimit të elaboratit, ku ky një çmim i cili nuk kërkon as diskutim se si do të kryhej apo edhe lidhja me njësinë kërkuese mund të vijë deri tek ky çmim që ky pozicion të mos ekzekutohet. Në bazë të këtyre vendimeve ne kemi kontratën e nënshkruar në mes KK.Prizren për shërbime të kësaj lëmie me numër të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1 Po ashtu për pozicion Punimit të elaboratit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për dokumentet planifikuese komunale është një çmim i pa komentueshëm 0.24Cent duke e ditur që është një çmim komplet për Objekt të Ri ku për punimi i elaboratit të tillë duke llogaritur edhe fitimet e kompanisë minimumi i mundshëm është 95.00€ gjithashtu punimi i elaboratit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për dokumentet planifikuese komunale është një çmim i pa komentueshëm 0.24Cent duke e ditur që është një çmim komplet për Objekt të Ri ku për punimi i elaboratit të tillë duke llogaritur edhe fitimet e kompanisë minimumi i mundshëm është 95.00€. Çmimi i ofruar nuk mund të mbulojë as çmimin e letrës për 3-kopje fizike të lidhura e aq më pak përgatitjen e elaboratave të tilla, dhe raporteve të tjera në bazë të udhëzimeve administrative për ndërtim.

Ndërsa Autoriteti Kontraktues pas kërkesës sonë për rishqyrtim ka kërkuar nga ana e këtij GOE ANALIZE Financiare të detajuar për ofertën e tyre ku kërkesën do të bashkëngjisim edhe më poshtë për çmimet të cilat i ka ofruar duke e parë që ky GOE ka çmimet e ulëta, ne pas qasjes kemi analizuar edhe letrën standarde nga ana e këtij GOE është shumë interesant fakti se në këtë sqarim nuk është paraqitur asnjë ANALIZË Financiare e detajuar por vetëm një letër në të cilën janë komentuar rikapitullimet e Pozicioneve të çmimit të papeshuara për pikat A, B, C si dhe një përgjigje e cila është vetëm gjithëpërfshirëse aspak profesionale dhe aspak financiare, pasi që me cilin do laborator të gjeomekanikës që bashkëpunuan ky GOE dhe i cili Operon në Kosovë është e pamundur që çmimi për shpimin gjeomekanik për m³/ të jetë 0.35Cent, ndërsa e njëjta gjë është edhe për Punimin e elaboratit të VSM, VNM-çmimi prej 0.24Cent për komplet objektin, është e pamundur që të realizohet një matematikë shumë e thjeshtë. Ndërsa Analizën Financiare sipas kërkesës nuk ka arritur që të ofrojë pasi që çmimet të cilat janë ofruar janë çmime jo-normalisht të ulëta dhe as që ka mundur që të ofrojë dëshmi që këto janë çmime të tregut. Në bazë të saj Komisioni i vlerësimit është dashur që të refuzoj sqarim e ofruar nga GOE, duke u bazuar në sqarimet e dërguara GOE nuk ka dëshmuar asesi një ANALIZË FINANCIARE të çmimeve që është përgjegjësi e Komisionit të vlerësimit, pasi që ka bërë shkelje të deklaratës nën betim. Kërkojmë nga ana juaj që të merret seriozisht kjo Ankesë pasi që është e bazuar në fakte të lartë cekura, në vendime duhet që ky OE të eliminohej dhe refuzohet ky GOE si i papërgjegjshëm. AK është dashur që të konsiderojë si jo-normalisht të ulët këtë GOE pasi që në bazë të Rregullores 001/2022 për prokurim publik neni 17-Punët ku 17.27 shkruhet qartas -Gjatë arsyetimit të çmimeve të cilat janë konsideruar si jo-normalisht të ulëta nga Autoriteti Kontraktues, siç është e rregulluar në nenin 61 të LPP, autoriteti kontraktues mund të merr parasysh si ekonominë e procesit të prodhimitarisë, zgjidhjet teknike dhe kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin. Elementet që lidhen me mos-pajtueshmërinë me rregullat për sigurinë, kushtet e punës, ligjit të punësimit ose të punës mund të merren parasysh për të refuzuar një tender jo normalisht të ulët, ndërsa i gjithë stafi i angazhuar në këtë procedurë të tenderimit janë me kontrata mbi vepër që i bie që kjo kompani do të angazhojë këtë staf vetëm për këtë projekt si e tillë as që do të mund të përmbush obligimet. Ku dhe vetëm nga shikimi i parë i çmimeve të ofruara janë jo të besueshme për objektin e kontratës dhe nga këto çmime ka gjasa për një ndikim negativ në performancën e implementimit të kontratës. Pas sqarimit të ofruar, ju si AK keni kërkuar edhe dokumentacionin shtesë ku është kërkuar: Pas rivlerësimit i janë kërkuar edhe njëherë dokumentet e Pranueshmërisë së Operatorëve Ekonomik Ne pas qasjes që kishim kemi parë që dokumentet në 1,2 nuk janë dorëzuar fare (nuk janë ngarkuar as ne eprokurim), përderisa një gjë është ri kërkuar pasi që në kërkesën e parë për rishqyrtim një çështje që kishim ngrit është pasi që nuk janë kërkuar vërtetimet për pronarët si dhe njëri nga anëtarët e koncersiumit nuk ka dorëzuar marrëveshjen me ATK pasi që në vërtetim cekej që është në marrëveshje me ATK ndërsa për mos dorëzimin e tyre AK është dashur të eliminojë këta GOE. Gjatë prezantimit të dokumentacionit ne nuk kemi hasur ne eprokurim që janë dorëzuar dokumentacionet e kërkuara sipas letrës standarde por vetëm Pika 3 është plotësuar. Krejt çka është sjellë është vërtetimi nga Gjykata për drejtuesit, menaxherët e saj, ku dhe këto vërtetime janë të pa verifikueshme pasi që nuk lexohet nga ana e QR kodit si te tillë këta OE është dashur që te eliminohen nga procedura dhe jo te favorizohen për dhënie te

kontratës. Ndërsa në qasjen e kaluar për kërkesën 1-është kërkuar që të ofrohet edhe marrëveshja me ATK në rast se janë në marrëveshje mirëpo një gjë e tillë nuk është ofruar, edhe pse anëtar i konkersiumit” N.SH. Geo-Map” është në marrëveshje për obligimet e tyre ndaj ATK-së. Florim Emini B.I, ka ofruar vërtetimin nga ATK që është në marrëveshje me këste, ku AK është dashur që të kërkoje nga ky Anëtar Marrëveshjen në mes të kompanisë dhe ATK, pasi që ne kemi dyshime që kjo marrëveshje është e lidhur pasi që është dorëzuar tenderi. Ne e kemi të paqarte se si një OE i cili ka borxhe të pa shlyera favorizohet. Në nenin 65 të LPP thuhet, cituar (shih: paragrafi 1): Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj (shih: Paragrafi 4.9) është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë. Në të vërtetë, shprehja "aktualisht" do të thotë se çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në DT dhe në njoftim për kontratë kërkohet nga të gjithë OE e interesuar për të marrë pjesë në aktivitet të prokurimit që të deklarojnë se janë "te pranueshëm" për të marrë pjesë në aktivitet të prokurimit, kështu duke bashkëngjitur edhe deklaratën nën betim mbi këtë. Ndërsa gjithashtu pas kërkesës 26.07.2024- kjo marrëveshje nuk është sjell edhe pse është kërkuar. Deklarata për menxherin e kontratës është një deklaratë e cila nuk është e nënshkruar dhe nuk është e vulosur nga të dy anëtarët e tenderit, por vetëm nga njëra kompani si e tillë ky OE është e papërgjegjshëm. Ne me datën 02.08.2024 kemi pranuar Vendimi mbi Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nr.2 ku në këtë vendim Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer përgjigje saj përket kërkesës sonë për rishqyrtim. Në bazë të këtyre pretendimeve të kompanisë sonë të ngritura me kërkesën për rishqyrtim mund të konstatohet se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, më konkretisht nenin 108/A, duke mos u përgjigjur dhe arsyetuar përgjigjet në pretendimet tona ankimore, i njëjti ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave. Ndërsa për OE tjetër konkurrese nuk kemi cekur shkeljet pasi qasja për te ka qene e kufizuar pasi që ka mbushur kërkesën për sekret Afarit-Aneksin3. Duke e parë favorizimin që është bërë në këtë procedure të tenderimit tek ne lind vetëm dyshimi që kjo procedure e tenderimit është një procedura e cila është proceduar për një operatore ekonomik, si dhe lindin dyshimet për bashkëpunim, pasi që ne si kompani kemi ofruar çmimet të cilat janë çmime të tregut të cilat i shihni edhe me lartë të analizuar dhe diferencën e tyre, kurse çmimet e ofruara nga operatorët ekonomik në fjale, lindin dyshimet se si do të kryhen këto shërbime, me çfarë profesionalizmi apo është e kurdisur edhe paramasa që të punohet një pozicion ku OE i shpallur fitues ka çmim më të favorshëm duke e përfshirë edhe njësinë kërkuese të hartimit të paramasave.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Studio Hapsira” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I): “Në paramasën dhe paralogarin të rekapitullimi OE I rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim me shumë se dy Numra mbas presjes dhjetore dhe është dashur nga OE të Konsiderohet i pa përgjegjshëm Sipas rregullores A01-Rregullore Nr 001/2022 te LPP neni 17 paragrafi 17.11 i LPP thotë: Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse Ofron çmim me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet ta përcaktojë në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë listën e çmimeve jo-standarde. Lidhur me këtë pretendim ankimorë janë raste të Gjykuar në OSHP- “Res Juridicata” në ku përraste të njëjta Kompania GeoMAP është eliminuar në Kuvendin Komuna në Prizren aktivitet e Prokurimit : 1. Titulli: Incizimet gjeodezike për projektet e DSHP-se ne Komunën e Prizrenit.

Pretendimi i dytë (II): “OE rekomanduar për kontratë te instrumente gjeodezike nuk i ka dorëzuar instrumentet gjeodezike në pajtimi me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar 1 Stacion Total TCR ka ofruar instrument gjeodezik TC : TCR është instrument gjeodezik Stacion Totale me llaser , ndersa OE ka ofruar instrument gjeodezik TC I cili është pa llaser ,në rastin konkret OE ka dorëzuar instrumentin gjeodezik TC 407 I cili nuk është në pajtim me kërkesat e autoriteti kontraktues është dashur të jetë TCR407 ku dallimet janë të ndryshme është kërkuar instrument gjeodezik stacion total me llaser , ka ofruar instrument gjeodezik stacion total pa llaser Në këtë rast AK ka shkelë nenin 40.13 i cili thotë se AK do t’i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/ dosjen e tenderit. Gjithashtu AK ka shkelur edhe nenin 62 të LPP i cili thotë 62.2 Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistemin të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit. 62.3 Në rast të tërheqjes së kërkesës për rishqyrtim nga ana e ankuesit, Autoriteti Kontraktues, respektivisht zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, ka autoritetin të ndërprerjes së procedurës e mëtejme të Rishqyrtimit ose të vazhdojë shqyrtimin e pretendimeve të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim. 9/4 Në këtë rast AK nuk ka dhënë arsyeshmëri bindëse për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim tonë .”

Pretendimi i tretë (III): “Gabime aritmetikore me shumë se 2% pasi në normën e TVSh OE i rekomanduar ka vendosur Normen Tvsh0.18 % i cili edhe nëse mbledh me çmimin pa TVSh apo nëse kalkullohet me formulën e përcaktuar nga Akt për kalkulimin e çmimin devijim i gabimit del 17.2% për secilin pozicion të llogaritur për secin kolon të llogaritur po ashtu në nëntotale dhe në rekapitullimin për poentim Shembull praktik Pozicioni 1.1. tash e çmimi 3.5 nuk 0.18 por 0.53 dhe ne shumëzohet me çmimin pa TVSh del 4.03 e jo 4.13 gabimi më i madhe se 2% Jo plotësisht aritmetike në tender, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë egzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë de dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Njoftimi për tenderuesin përkatës për korigjim të tillë të në tenderi do të bëhet me anë të përdorimit të formularit standard të aprovuar nga KRPP-ja B49. Megjithatë, në asnjë rast nuk

mund të korigjohet 45.24. Bazuar në nenin 56.3 të LPP. Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe /ose në dosjen e tenderit.”

Pretendimi i katërt (IV): “Pozicionet 1.6,1.7,1.8 Projektimin e urave i ka çmimet jo normalisht të ulëta me çmimin e tregut pasi një urë nuk mund të projektohet për 0.10cent/m’ , edhe në rast se ka trajtuar këtë çmim jo normalisht të ultë OE është dashur ta bëjë Publike arsyshmerinë di është bindur autoriteti për dhënie kontratës të njëjtin dokument nuk e ka bo publike në e-procurim ka trajtuar lëndën jo transparente Me këtë rast AK ka shkelur nenin 41.6 me rast nuk ka kërkuar letër standard nga OE për trajtimin e tenderëve jo-normalisht të Ulët. 10/4 Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderueshëm të punëtorëve kanë mbetur pa punë , duke llogaritet shpenzimet , kamatatë ,tarifën e avokatit deri sa të zgjidhen kontekstet. Vlera e dëmit kap vlerën 100,000.00€, të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë 9. Dëmet materiale Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim. 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë: a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit. b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”. “

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK - nuk ka kthyer përgjigje ne lidhje me rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE “Arhiko.ing” SH.P.K. ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit kurse operatori tjetër “Studio Hapsira” SH.P.K. nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Arhiko.ing” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0726 kanë vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Operatori ekonomik ankues *ARHIKO .ING SH.P.K.* në sqarimet e tij për pretendimin e parë e ka ofruar një kronologji dhe dëshmi të cilat i referohen çmimeve të ofertës si “ çmime abnormalisht të ulëta” po ashtu i’u ka referuar edhe dy Vendimeve të OSHP-së, me numër 1034/2023 i datës: 07.02.2024, dhe vendimit 431/24, duke shtruar si argument në rrafshin e Analogjis Juridike, të dy vendimeve të më hershme e që konsideron se janë në ekuivaalencë me pretendimit aktual.

Eksperti shqyrtues gjatë analizimit të çmimeve të ofertës të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë: *Grup i Operatorëve Ekonomik Nil Engineering SH.P.K.; N.SH. GEO-MAP.*, konsideron se çmimet e ofruara janë çmime të cilat nuk korrespondojnë me çmime reale të tregut, eksperti shqyrtues konsideron se Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Klinës, gjatë ri-vlerësimit duhet ta bëjë një hulumtim më të gjërë të tregut duke siguruar dëshmi (marrë oferta në tregt prej për të njëjtat pozicione) duke siguruar se çmimet e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk janë çmime abnormalisht të ulëta, dhe se çmimet e ofruara janë çmime reale dhe të njëjtat nuk hyjnë në çmime “ *manipulative* ”, andaj për ta vërtetuar këtë Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal i Klinës, duhet ti ketë parasysh rrethanat Juridike si: Vendimet e lartëcekura të OSHP-së, pajtueshmërinë me legjislacionin për prokurim publik, dhe të ndermerrë hapa-veprime për të siguruar se Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Eksperti shqyrtues gjatë kërkimit (verifikimit) në platformen E-prokurim, nuk ka mundur ti gjej kërkesat e pranueshmërisë, andaj pretendimi i OE- ankues është i qëndrueshëm.

Përfundim:

Eksperti shqyrtues gjatë analizimit të dëshmive, fkatëve dhe rrjedhës së procedurës vlerëson se duhet të bëhet Anulimi mbi njoftimin për dhënje dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me pretendimet e OE “Studio Hapsira”SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0734 kanë vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I) :Eksperti shqyrtues gjatë verifikimit se AK a e ka vendosur kërkesën në dosje të tenderit apo jo, ku ka përcaktuar informaten se lejohen cmime me me shumë se dy numra pas presjes dhjetore, të njëjten nuk e hasur në dosjen e tenderit, andaj pretendimi i OE- ankues është i qëndrueshëm dhe në pajtim me nenin e rregullores të përcaktuar më lartë.

Konstatimi i dytë (II):Eksperti shqyrtues gjatë egzaminimit të dëshmive lidhur me pretendimin e OE-ankues, sqaron se pretendimi i i dytë i operatorit ekonomik ankues është i qëndrueshëm.

Konstatimi i përgjithshëm: Pas trajtimit të dëshmive, argumenteve dhe rrjedhës së procedurës, eksperti shqyrtues Rekomandon që ky proces i prokurimit gjatë ecurisë në faza, ka mangësi dhe nuk ka arsyeshmëri dhe kredibilitet profesional e autoritativ të vazhdohet tutje.

Të rekomandohet një operator ekonomik për kontratë me çmime të cilat janë në kundërshtim me nenin e LPP-së dhe rregullores për Prokurim Publik *përkatësisht nenin 17.11*, dhe të provohet të vazhdohet tutje duke i refuzuar kërkesat për ri-shqyrtim të operatorëve ekonomik ankues, duke ri-konfirmuar Njoftimin e Vendimit të Autoritetit Kontraktues, me të gjitha këto mangësi dhe mospajtueshmëri me legjislacionin për prokurim publik (mospajtueshmëri në aspektin administrativ) është joprofesionale dhe joligjore nga një Autoritet Kontraktues si në këtë rast Kuvendi Komunal i Klinës.

Andaj, eksperti shqyrtues rekomandon që ky proces i prokurimit të anulohet në tërësi, pasi që nuk janë të mbrojtura nga Autoriteti Kontraktues kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit përkatësisht rregullores për prokurim publik me numër 001-2022, neni 17.11.

Eksperti Shqyrtues sqaron se pretendimet e OE-ankues janë të qëndrueshme, mirëpo Vendimet dhe hapat procedural të ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues, për këtë procedurë nuk sigurojnë ligjshmëri në këtë proces, andaj procura si e tillë duhet të anulohet në tërësi.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, ka pasur nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ka qenë e nevojshme të dëgjohen edhe palët.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, nuk përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Në rastin konkret nga raportet e ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0726 dhe 2024/0734, pretendimet ankimore nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit dhe dokumentet nga AK, Paneli Shqyrtues nuk ja fal besimin tërësisht raporteve të ekspertit shqyrtues, në mungesë të provave dhe kundërthënieve ndërmjet këtyre raporteve, ku njëri raport i ekspertizës ka rekomandim që procedura të kthehet në ri-vlerësim, ndërsa raporti tjetër që procedura të anulohet në tërësi.

Lidhur me pohimet ankimore të OE ankues “ARHIKO ING” SH.P.K

Ankuesi ka pretenduar se AK, në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT). Pasi që çmimet e ofruara janë çmime jonormalisht të ulëta. Pretendimi tjetër i ankuesit është se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka sjellur dokumentet e pranueshmërisë së Operatorëve Ekonomik, duke i munguar vërtetimet e ATK dhe vërtetimet e Gjykatave.

Lidhur me të gjitha këto pretendime eksperti shqyrtues nuk ka kryer detyrat dhe obligimet e tij konform autorizimit dhe dispozitave ligjore, konkretisht të nenin 113 dhe 114 të LPP, duke mos e argumentuar as duke mos bërë qoftë një hulumtim të tregut apo të kontratave paraprake të këtij AK apo edhe të kërkoj sqarime nga ankuesi dhe AK. Sipas nenit 114, paragrafit 1, citat: *“Eksperti shqyrtues, në afat prej dhjetë (10) ditësh, menjëherë pas emërimit të tij do të: (i) shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse, (ii) intervistojë, nëse ai e sheh të arsyeshme ose të nevojshme, cilindo zyrtar, nëpunës ose këshilltar të autoritetit kontraktues ose palës ankuese, dhe (iii) pajisë panelin shqyrtues, ankuesin dhe kryesuesin e autoritetit kontraktues me një vlerësim me shkrim mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë.”*

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në nenin 61 të LPP dhe dispozita tjera të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht nenit 41, përfshirë nenin 41.3, ku i lejohet AK të kërkoj sqarime shtesë për të shpjeguar çmimet e ofruar, dhe këtë autoriteti kontraktues konkretisht komisioni i vlerësimit e ka bërë përmes platformës së prokurimit me dt. 23.07.2024, duke i kërkuar këto sqarime dhe OE tani i rekomanduar për kontratë i ka dërguar këto sqarime duke deklaruar se qëndrojnë mbrapa ofertës së tyre dhe duke ofruar arsyeshmëri për të cilën AK është pajtuar. Andaj Paneli Shqyrtues këtë pretendim e kualifikon si pjesërisht të bazuar por konsideron se pas hapave ligjor që AK i ka ndjekur dhe në mungesë të një hulumtimi nga ana e ekspertit shqyrtues dhe duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të LPP, citat: *“ Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.”*, vendos që ta konsideron si të mirëqenë këtë veprim të AK.

Lidhur me pretendimin tjetër sa i përket vërtetimave të ATK dhe të Gykatës, në mungesë të provave dhe komunikimit të ekspertit me AK, atëherë OSHP me dt. 14.10.2024, përmes emailit i drejtohet AK: *“Të nderuar, OSHP është në shqyrtim të ankesave me nr. 2024/0726 dhe 2024/0734, lidhur me aktivitetin e Prokurimit “Hartimi i Projekteve zbatuese” me nr. të prok. 634-24-4723-2-1-1. Në njërin prej këtyre ankesave edhe ankuesi por edhe eksperti shqyrtues kanë deklaruar se OE të rekomanduar për kontratë, I mungojnë dokumentet e pranueshmërisë, si vërtetimet e Gjykatës dhe të ATK dhe ngase të njëjtat nuk gjenden në platformën e e-prokurimit. Dhe në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim nuk keni japur ndonjë arsyetim, ashtu sikurse nuk keni japur arsyetim as në përgjigje ndaj raporteve të ekspertit shqyrtues. OSHP kërkon nga ana juaj si iniciuese e këtij aktiviteti të prokurimit që ta njoftoni OSHP se këto dokumente a janë dorëzuar nga ana e OE në AK dhe të njëjtat të bashkngjiten në emailin e OSHP, si provë.”* Dhe AK po me dt. 14.10.2024, përgjigjet: *“Pershendeteje , Te bashkangjitur I gjeni dokumentet e pershtatshmeris per O.E te propozuar per kontrat.Te cilat jane te ngarkuar edhe ne E-Prokurim ne linkun Dokumentet letrat standarte Dokumentat per Oeperatorin ekonomik. Pra te cilat kane gene te ngarkuar.”* Paneli shqyrtues konsideron se AK dhe secila palë në procedurë duhet ta

respektoj interpretimi i KRPP nr. 6 i datës 22.11.2022 dhe secili person qoftë fizik apo juridik janë përgjegjës për veprimet e veta në respektim të dispozitave ligjore, e konkretisht komisioni i vlerësimit konform nenit 59.1 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE “Studio Hapsira” SH.P.K

Ankuesi ka pretenduar se në paramasën dhe parallogarin të rekapitullimi OE I rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim me shumë se dy Numra mbas presjes dhjetore dhe është dashur nga OE të Konsiderohet i pa përgjegjshëm, pastaj, OE i rekomanduar për kontratë të instrumente gjeodezike nuk i ka dorëzuar instrumentet gjeodezike në pajtimi me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar 1 Stacion Total TCR ka ofruar instrument gjeodezik TC : TCR është instrument gjeodezik Stacion Totale me llaser , ndersa OE ka ofruar instrument gjeodezik TC I cili është pa llaser, tutje Gabime aritmetikore me shumë se 2% pasi në normën e TVSh OE i rekomanduar ka vendosur Normen Tvsh0.18 % i cili edhe nëse mbledh me çmimin pa TVSh apo nëse kalkulohet me formulën e përcaktuar nga Akt për kalkulimin e çmimin devijim i gabimit del 17.2% për secilin pozicion të llogaritur për secin kolon të llogaritur po ashtu në nëntotale dhe në rekapitullimin për poentim, si dhe Pozicionet 1.6,1.7,1.8 Projektimin e urave i ka çmimet jo normalisht të ulëta me çmimin e tregut pasi një urë nuk mund të projektohet për 0.10cent. Paneli Shqyrtues lidhur me këto pretendime sqaron se ky aktivitet i prokurimit është përcaktues kriteri i çmimit më të ulët me poentim dhe këto çmime të ofruara pas presjes dhjetore nuk janë çmimet e ofertës por janë çmime të poentimit dhe duke u nisur nga nenit 27.14 i RRPP, citon: *“Funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në baze të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave.”* Kështu që, ai çmim me poentim të rikapitullimi është çmim i cili AK do të paguaj. Po ashtu edhe në DT të këtij aktiviteti në nenin 20 figuron se: *“Çmimi i ofertuar lejohet që të shenohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numer i shenuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për baze në llogaritje të vlerës së ofertes.”*.

Lidhur me pretendimin se OE i rekomanduar ka ofruar stacion total pa llaser dhe vetëm me TC, kjo është e paqëndrueshme sepse në bazë të dëshmive, specifikisht faturës nr. 109/04 të datës 3.5.2004, shkruan në gjuhën serbe se TC407 është me llaser, po ashtu edhe përmes marrëveshjes me NNP UNIProjektka ofruar me dokumente tjera me DUD dhe deklaratë nga zyra doganore – Terminali Pejë se ka Total station me TCR, përfshirë edhe pagesat.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se të dy OE ankues nuk kanë dëshmuar mjaftueshëm se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar duke u bazuar në nenet 59 dhe 60 të LPP.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: *“Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”,* atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit) dhe duke e pasur parasysh se AK në mendimin e tyre në relacion me raportin e ekspertizës ka deklaruar se është në diskrecion të AK vënia në zbatim në rast të nevojës edhe neni 59.4 sa i përket devijimeve të vogla, dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Njëherit Paneli shqyrtues ashtu sikurse AK vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të

Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç’rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertat e ankueseve.

- Përfundimi –

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkrësat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësisht ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - ARHIKO .JNG SH.P.K., STUDIO HAPSIRA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: